

20151945375

L I G J
PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM - BANKA BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN E DYTË PËR PËRMIRËSIMIN
E SHËRBIMEVE KOMUNALE

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore me hua në shumë prej 25.000.000 euro, dedikuar për realizimin e Projektit të dytë për përmirësimin e shërbimeve komunale.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen për hua për Projektin të dytë për përmirësimin e shërbimeve komunale që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 18 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë vjetësh.

Shkalla vjetore e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor me shtrirje variabile.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Bankës Botërore provizion në shumë prej 0,25% nga shuma e huas.

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Bankës Botërore provizion në shumë prej 0,25% nga pjesa e patërhequra e huas në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet në 26 këste gjysmëvjetore. Duke filluar nga 15 marsi 2021 deri më 15 mars 2033 do të paguhet 25 këste gjysmëvjetore secila në shumë prej 3,85% të shumës së huas, ndërsa më 15 shtator 2033 do të paguhet kësti i fundit në shumë prej 3,75% të shumës së huas.

Neni 4

Shfrytëzues të mjeteve të huas nga neni 1 të këtij ligji janë komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit që i plotësojnë kushtet për huamarrje në pajtim me Ligjin për borxh publik dhe Ligjin për financim të njësisve të vetëqeverisjes lokale.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe shfrytëzuesve të mjeteve të huazuara nga neni 4 i këtij ligji, Ministria e Financave do të lidhë marrëveshje të veçanta për hua.

Neni 6

Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga mjetet që do të grumbullohen me pagesën e mjeteve të huazuara nga shfrytëzuesit e mjeteve të huas nga neni 4 i këtij ligji në pajtim me marrëveshjet e veçanta për hua nga neni 5 i këtij ligji dhe nga Buxheti i Republikës Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".